

VENDIM
Nr. 307, datë 20.4.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE,
PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushte-tuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, të pikës 1/3, shtohen emërtesat “Qendra Kombëtare e Biznesit” dhe “Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut”, si dhe shfuqizohet emërtesa “Qendra Kombëtare e Licencimit”.

b) Në shkronjën “b”, të pikës 1/3, emërtesa “Qendra Kombëtare e Regjistrimit”, shfuqizohet.

c) Në lidhjen nr.8, që përmendet në pikën 8, shtohet emërtesa “zëvendës drejtor i Agjencisë së Shërbimeve të Sportit – kategoria III-a/1”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi:

a) për Qendrën Kombëtare të Biznesit, Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe pozicionin zëvendës drejtor i Agjencisë së Shërbimeve të Sportit të fillojnë nga data e emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2016;

b) për Qendrën Kombëtare të Licencimit dhe Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të fillojnë nga momenti i fillimit të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI